

Tri pyetjet / Ministria e Financave

1. EIC: Sipas mendimit tuaj, cila është perspektiva ekonomike për dy vitet e ardhshme?

Ministri Hoti: Rritja ekonomike afatmesme pritet të sillet mesatarisht rreth 4%. Përveç investimit dhe konsumit, diversifikimi i eksporteve të mallrave pritet të kontribuojë në një rritje më të qëndrueshme. Kjo do të thotë që ne do të shohim një rikthim të vazhdueshëm nga stagnimi në vitin 2014.

2. EIC: Cilat janë instrumentet më të mira për të tërhequr investimet dhe për të parë rritje ekonomike?

Ministri Hoti: Ne jemi të vetëdijshëm se investitorët e huaj janë, mbi të gjitha, të interesuar në një klimë të Biznesit të drejtë dhe konkurrues. Kosova ka ecur mirë në drejtim të lehtësimit të procedurave të biznesit, e cila është konfirmuar nga raporti i Të Bërit Biznes të Bankës Botërore për disa vite me radhë. Avancimet e mëtejshme në legjislationin ekzistues, si dhe vetë zbatimin të ligjit, janë në vazhdim dhe janë të mbështetura fuqishëm nga disa prej Partnerëve tonë kryesorë të huaj, si USAID, Komisioni Evropian, GIZ, etj.

Një nga qëllimet kryesore të Ministrisë së Financave është që të promovojë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik duke ruajtur stabilitetin makro-fiskal. Ne e kemi njohur bilancin tregtar negativ si një nga problemet kryesore në ekonominë e Kosovës. Reformat aktuale të politikave tatimore synojnë prodhimin vendor, e cila do të hapë rrugën për rritjen e bashkëpunimit me investitorët e huaj në të ardhmen e afërt dhe rritjen e aftësisë konkurruese të Kosovës në tregjet ndërkombëtare. Mënyra si ne e shohim, forcimi i tregut të brendshëm do të vendosë një bazë të fortë për rritje të qëndrueshme të eksportit në të ardhmen në mënyrë që ne të shohim atë duke kontribuar në rritje

3. EIC: Cilat ndryshime, që ju përmendët, do të kontribuojnë në një rritje ekonomike më të fuqishme?

Ministri Hoti: 1) Lista e lirimeve/përrjashtimeve nga detyrimet doganore për aktivitete prodhuese, 2) Lirimi nga TVSh-ja në inputet e lidhura me linjat e prodhimit (kjo mund të ndihmojë të lehtësojë qasjen në makineri moderne, e cila shpesh nuk është në dispozicion në Kosovë dhe mund të jetë e kushtueshme për kompanitë vendase); 3) Sektori i shërbimeve të TI-së konsiderohet si një sektor me potencial të lartë zhblllokues në Kosovë. Prandaj, ndryshimet e fundit tatimore përfshijnë lirimet nga TVSH-ja për pajisjet e TI-së, në mënyrë që ne të mund të forcojmë një sektor i cili konsiderohet të shfaqë efekte të mëdha në shumë sektorë të tjerë të ekonomisë; 4) Reduktimi i procedurave administrative dhe heqja e kërkesës për certifikatën e eksport-importit pasi që tashmë të gjitha bizneset në Kosovë posedojnë numrin e identitetit fiskal. Këto janë vetëm disa stimuj që do të kontribuojnë pozitivisht në periudhën e ardhshme afatmesme.